

PERMBLEDHEJ E VNM-SE PER AKTIVITETIN:

Industria minerare. 3.1/e Perzjerja e çimentos ose perdorimi i çimentos ne mase te madhe, por jo ne sheshin e ndertimit, perfshire ambalazhimin, dhe perzjerjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve te betonit dhe produkteve te tjera te çimentos;

3/10. Prodhim i produkteve abrazive dhe produkte te tjera minerale jo metalike (nyje fraksionimi inerte guri dhe zhavori);

Veprimtarite e katranit dhe bitumit. 7.3/c . Veprimtarite qe nuk perfshihen ne piken 7.3 dhe 7.b ose ne pika te tjera te kesaj shtojce qe perfshijne ngrohjen por jo distilimin e katranit ose bitumit ne lidhje me ndonje veprimtari prodhimi (prodhim asfalto betoni); **Industriete prodhuese te makinerive dhe pajisjeve ID.10.4.** Riparim dhe mirembajtje e makinerive dhe pajisjeve (ofiçine)

("NYJE FRAKSIONIMI DHE LARJE INERTESH, LINJE E PRODHIMEVE TE BETONIT DHE PARAFABRIKATEVE, ETJ) DEPOZITIM TE TYRE, VEPRIMTARI TE KATRANIT DHE BITUMIT: FABRIKE ASFALTO BETONI, ZYRA , OFICINE, MAGAZINE ETJ. PER NEVOJA TE PRODHIMIT DHE MAQINERIVE TE KANTJERIT TE PRODHIMIT")

Hyrje

Zhvillimet e vrulleshme te ekonomise Shqiptare gjithmone jane lidhur me rritje te gjere ekonomike. Kjo ka shtruar si nevojte ngritjen dhe funksjonimin e shume linjave dhe aktiviteteve te reja ne te cilat ana funksjonale e tyre eshte e lidhur domosdoshmerisht me perdorimin e pa nderprere te materialeve ndertimore sa me cilesore. Gama e gjere e sektoreve te tille te karakterit prodhues tregon se nevojat per keto artikuj jane gjithmone imperative dhe te domosdoshme.

Kompania "VICTORIA INVEST" sh.p.k. eshte nje nder kompanite mjaft te njohura te qarkut te Elbasanit dhe me gjere aktiviteti i te ciles lidhet me:

- Veprimtari prodhuese;
- Ndertim objektesh eksport materiale ndertimi;

- Pastrim gjelberim evakuim i mbetjeve urbane ne siperfaqet urbane dhe siperfaqe te brendeshme;
- Transporte kombetare te lendeve bituminoze;
- Transporte urbane dhe interurbane te udhetareve dhe transport nderkombetare udhetarësh;

Kjo shoqeri eshte themeluar ne vitin 2003 duke patur si aktivitet fillestare "Veprimtari prodhuese dhe ne fushen e ndertimit.

Ne vitin 2004 shoqeria rrit aktivitetin e saj duke e shtuar ate ne fushen e "pastrim dhe gjelberim qytet etj"., ndersa ne vitin 2006 shoqeria vazhdon e rrit aktivitetin e saj duke i konkretizuar ato me "Transport urban dhe inter urban te udhetareve"

Subjekt i ketij materiali eshte **"Funksionimi Fabrikes se prodhimit te asfalto betonit, nyjes se prodhimit te materialeve inerteve dhe nyjes se prodhimit te betonit dhe artikujve prej betoni"** si nje hallke e domosdoshme e shtimit dhe mirembajtjes se objekteve dhe infrastrukturave ndertimore.

Kuptohet qe ushtrimi i ketij aktiviteti kerkon qe te kihet parasyshe dhe mbrojtja e mjedisit.



Kerkesat e perdorimit te tokes

Sheshi i perzgjedhur nga shoqeria « Victoria Invest »sh.p.k. ze nje pjese te ish repartit te gaz-golderave brenda territorit te kombinatit metalurgjik



Territori i fabrikes kufizohet :

Veri	me linjen e prodhimeve te konstruksjoneve metalike
Lindje	park magazinimi karburantesh
Perendim	fushe e lire
Jug	fushe e lire



Koordinata e objektit i vendosur ne harten 1 :10000

Koordinatat e fabrikes se asfalto-betonit

pikat	1	2	3	4
	44 17 438	44 17 509	44 17537	44 17 467
	45 50 426	45 50 456	45 50 396	45 50 367

Koordinatat e nyjes se betonit

Pikat	1	2	3	4
	44 17 488	44 17 559	44 17 589	44 17 517
	45 50 352	45 50 379	45 50 316	45 50 267

Koordinatat e nyjes se seleksjonimit te inerteve

Pikat	1	2	3	4
	44 17 369	44 17 440	44 17 470	44 17 398
	45 50 292	45 50 319	45 50 333	45 50 227

Zona kadastrale 3965 Planshetat El:I-6 EL: J-6

Adresa dhe kontakti i subjektit

Subjekti "Victoria Invest", Sh.P.K. Elbasan ,Lagja "29 Nentori"

Rruga "11 Nentori", pallati prane tatim

taksave, kati 2

Perfaqesuesi Shoqerise : Fatmir Kuçi

Nr NIPTI K32712206U

Mynyra kontaktit : Tel Mob.0682095108-06840003282

Teknologjia e prodhimit te fabrikes ndare sipas nyjeve prodhuese

Pershkrimi i sistemit te shfrytezimit . Nyja e copetimit dhe fraksjonimit te inerteve

Lenda e para qe perbehet nga inertet lumore dhe/ ose Guret gelqerore sigurohen pothuajse prane objektit nga subjektet me license te rregullt per shfrytezimin e inerteve mbi lumin Shkumbin e me teje nga ato qe kane licensa per shfrytezimin

e karrjerave te gurit gelqerore. Nderkohe subjekti eshte miratuar nga qeveria per marrjen e inerteve lumore per shkak te ndertimit te rrugeve nacionale dhe te rendesishme per ekonomine e vendit.

Per zgjedhjen e sistemit te shfrytezimit kemi pasur parasysht keto faktore:

- Menyra e transportit te materialit inert;
- Menyra e kryrjes se punimeve per perpunimin dhe seleksjonimin e tije.

Tipet e mjeteve dhe mekanizmave qe parashikohen per ngarkim dhe transport.

Shoqeria ka parashikuar qe ngarkimi i mjeteve me materialin e perpunuar te behet me mjet ngarkimi me kove (tip rusp) me sistem e ecje me goma dhe kapacitet kove $1.5\text{m}^3\text{-}3\text{m}^3$.



Njesite e sherbimeve mbeshtetese:

Zyra dhe ambiente per perdorim nga personeli, kabina elektrike, magazine, oficina mirembajtje etj.

Procesi teknologjik i prodhimit dhe karakteristikat e tij. Impianti i fraksionimit dhe procesi i perpunimit te materialit inert.

Shoqeria "Victoria Invest" sh.p.k. ka investuar per aplikimin e nje teknologjie bashkekohore te standarteve europiane te prodhimit. Ky impiant eshte teper eficient persa i takon perdorimit te energjise, pjese teknologjike te ndryshme te saj ndertohen ose modifikohen me te reja, shpikje te reja inxhinjrike te cilat permiresojne eficencen dhe optimizojne perdorimin e energjise dhe ndikimin e tij ne mjedis. Kjo linje teknologjike sipas proceseve qe realizon perbehet nga keto njesi baze:

Sheshi i depozitimit te lendeve te para inerte si dhe bunkeri i depozitimit te materialeve inerteve qe vijne nga lumi nga furnitore te trete.




Bunkeri eshte edhe stacioni i pare i metrialit inert i cili i nenshtrohet nje numri te caktuar procesesh. Materiali inert qe depozitohet ketu do te jete gjithmone ne gjendje te lagur pasi do te sperkatet me uje per efekt te eliminimit te clirimit te pluhurave gjate procesit te copetimit te tije. Bunkeri i depozitimit ka formen e nje hinke me fund nga siper, nje kapacitet volumetrik relativ prej 20 m³, i ndertuar prej metali celiku me diameter flete prej 0.8 mm bunkeri eshte teper rezistent ndaj forcave mekanike. Ne bunker shkarkohet materiali inerte i cili nepermjet forces terheqese gravitacionale drejtohet ne sistemin e sistemin e sitosjes.

Skema teknologjike


1. Transportiere L=20 metra
2. Transportier L=20 metra
3. Transportiere L=20 metra
4. Transportier L=20 metra
5. Transportier L=16 metra
6. transportier L=12 metra
7. larese rere S=15 m²
8. Site me dy kate S=10 m²
9. Transportier L=21 metra
10. Fronto
11. Site me dy kate S=2 m²
12. pompe uji Q=4 m³/min
13. Transportier L=21 metra
14. Site me dy kate S=6 m²
15. transportier L= 20 metra
16. transportier L=16 metra
17. Transportier L=20 metra
18. Site me dy kate S=6 m²
19. Transportier L=21 metra

- 20. Transportier L=10 metra
- 21. Mulli 60 x 40 cm
- 22. Mulli 40 x 40 cm
- 23. transportier L=23 metra
- 24. Bunker dozatore 20 m³
- A. pult komandimi 5 x 3 metra
- B. Kabine elektrike 7 x 3 metra



Sitosja e lenda se pare ne siten me dy kate

Nga bunkeri ushqyes nepermjet nje transportieri (13), lenda e pare i nenshtrohet nje procesi paraprak te sitosjes ne siten (11) me siperfaqe prej 2 m² nga ku largohen fraksjonet e trasha nga ato te imetat. Materialet e imeta qe perfaqesojne nje pjese te rererave dhe mbetjeve te pa deshirueshme qe shoqerojne lenden e pare dalin ne pjesen e poshteme te sites nga ku largohen ne vendet e caktuara per depozitimin e tyre.



Parasitosja e lendes pare

Pjesa e materialit te trashe qe mbetet ne pjesen e sipërme te sites, nepermjet transportierit, kalohet per copetim ne fronton (10)

Copetimi i materialit inert ne fronto.

Eshte njesia agragate e dyte e procesimit te copetimit te materialit inert. Frontoja eshte nje paisje e cila ka nje bunker te vogel per futjen e lendes inerte dhe dy nofulla te fuqishme te perbera nga material special qe nepermjet levizjes se tyre



Fronto me nofulla

realizohet copetimi i materialit. Materiali tashme i copetuar ne fronto (10) qe vihet ne levizje nga nje motorr 5.5 kW, nepermjet transportierit(9) kalohet ne procesin tjeter te sitosjes

Fraksjonimi i materialit nepermjet sistemit te sitosjes(8).


Pas procesit te copetimit te materialit ne fronto, kuptohet qe tashme materiali i dale nga frontoja ka ne perberje te tije nje perzjerje granulometrike nga materiale

inerte te trajtes ranore deri ne copeza te medha me dimensione deri ne 5 cm. Per ndarjen e ketyre fraksjoneve materiali kalon ne nje site me dy kate me siperfaqe 8 m² ku pjesa e imet qe del nga pjesa e poshteme e sites dhe qe perfaqeson materialin me karakteristikat e reres, kalon ne nje larese rere ku realizohet proçesi i larjes se tije dhe me teje nepermjet nje transportieri (4) kalon ne vend grumbullimin e reres, ku trajtohet si produkt i gatshem se bashku me reren e marre gjate proçesit(natyrale)



Sita me dy kate

Pjesa mbi site qe perbehet nga material i trashe, nepermjet transportierit(23) kalohet ne procesin e grimtesimit ne mullinj.



Proçesi i therrmimit se materialit ne mullinj (21)(22)


Materiali i dale siper sites (8) nepermjet transportjerit (23) kalon ne proçesin e grirjes ne mullinjte (21)(22) te cilet jane te vendosur ne seri per te realizuar nje proçet sa me te plote te therrmimit te materialit inert.



Parimi i punes se mullinjeve eshte i tipit me çekiçe. Pasi materiali therrmohet ne mullinjte, nepermjet transportierit (19) kalon perseri ne nje proçes sitosje

Proçesi sitosjes pas bluarjes se materialit ne mullinj

Materiali i bluar ne mullinj tashme i nenshtrohet nje proçesi te sitosjes ne nje site me dy kate me siperfaqe 6 m² (18). Nga ky proçes fitohen dy fraksjone qe perfaqesohen nga pluhra teper te imeta dhe pluhura te imeta qe nepermjet tarnsportieve (5) dhe (6) depozitohen ne vend depozitimet e tyre te gatshem per tregetim. Pjesa e tjetër materialit qe mbetet mbi site nepermjet transportjerit (15) kalon ne nje proçes tjetër sitosje qe realizohet nepermjet sites (14) qe eshte perseri nje site me dy kate dhe ne te cilen realizohet fraksjonimi i 5 fraksjoneve



Sita e fraksjonimit perfundimtare me dy kate

qe jane fraksjonet mbi 10 mm te cilat nepermjet transportjerit (23) riciklohen per ne sistemin e bluarjes se perseritur ne mullinj, fraksjonet deri ne 10 mm te cilat nepermjet transportjerit (4) depozitohen ne vend depozitim per shitje, fraksjonet nga 5-8 mm qe nepermjet transportjerit (3), depozitohen ne vend depozitim per shitje, fraksjonet 2-3 mm qe nepermjet transportjerit (2) kalohen ne vend depozitim per tu shitur

Duhet te theksohet se te gjithë proceset e siperpermendura gjithmone shoqerohen me lagje me uje. Uji i cili dergohet ne cdo proces nepermjet nje pompe presjoni (12) qe ka nje prurje prej $Q = 4 \text{ m}^3/\text{min}$ dhe presjon optimal te punes 12 ata.

Kapaciteti prodhues .

Nga te dhenat e studimit tekniko ekonomik rezulton se kapaciteti prodhues i linjes do te jete

- Rere gjithesej do te prodhohen $50\,000 \text{ m}^3/\text{vit}$
- Granil i dimensjoneve te ndryshme gjithesej $70\,000 \text{ m}^3/\text{vit}$

Kjo do te varet nga kerkese oferta.

2.4. Lendet e para.

Lenda e pare qe perdoret per prodhim te materialeve inerte per ndertim jane kryesisht materiale inerte nga guroret dhe qe perbehen nga shkembinj karbonike nderkohe mund te perdoren dhe lende inerte nga lumi dhe qe perfaqesojne materiale me konsistence zhavori apo rere.

Te dhenat e shkurtera mbi perberjen e materialeve lumore jane pak a shume si me poshte

Permbajtia Mineralogjik e Agregatit

Klasat	+2.5mm (0.2%)	+1,25 mm (0.3%)	0.63 mm (15%)	+0.32 mm (60%)	+0.15mm (25,5%)
Copa karbonate	-	-		35%	36%
Copa Ranore	30%		22%	20%	15%
Gelqerore	25%	28%	32%		
Kalcit	3%	-	5%	5%	10%
Kuarc i paster	10%	12%	12%	15%	18%

Copa dru/qymyr	2 %	-			
Agregat shkemb.	30%	-	28%	20%	20%
Agreg.magmatik	-	30%			
Agreg.ranor	-	30%			
Mika	-	-	Deri 1%		Deri 1%

Perberja granulometrike e materjalit mbi 5 mm

- Klasa mbi 80 mm 17.5 %
- Klasa 40 – 80 mm 38.5 %
- Klasa 20 – 40 mm 18 %
- Klasa 10 – 20 mm 19%
- Klasa 5 – 10 mm 7 %

Perberja granulometrike e reres se lare nen 5 mm.

- Klasa mbi 2.5 – 5 mm 37 %
- Klasa 0.8 – 2.5 mm 29 %
- Klasa 0.5 – 0.8 mm 10.6%
- Klasa 0.3 – 0.5 mm 18%
- Klasa nen 0.15 mm 5.4 %

- **Pesha volumore** 2.18 t/m³
- **Pesha specifike** 2.62 gr/cm³
- **Ujethithja** 8.8 %

Te dhenat e shkurtra mbi llojin e gurit gelqerore qe mund te perdoret per therrmim dhe fraksjonim.

- CaO luhatet nga 48.6% deri ne 55.36%
- MgO luhatet nga 0.15% deri ne 0.47%
- Mbetjet e pa treteshme eshte nga 0.25% deri ne 0.60% me nje mesatare prej 0.43%

Elementet e tjere perberes te marre ne anallogji me zonen per rreth jane:

- SiO₂ nga 0.20-1.28%
- Al₂O₃ gjurme
- Fe₂O₃ = 0.048%
- K₂O = 0.01%
- Na₂O = 0.055-0.077%
- SO₃ = 0.055%
- H.K = 42.5-43%
- TiO₂ = 0%
- P₂O₅ = 0%

Nyja e prodhimit te betonit dhe artikujve prej betoni.

Sikunder dhe per materialin inert, ne linjar e ketij sistemi realizohen:

- beton si lende e pare per te trete
- elemente te ndryshem betoni te realizuar sipas formave dhe dimensjoneve te kerkuara

Impianti i prodhimit te betonit

Teknologjia e prodhimit te betonit eshte teknologji e thjeshte e standarteve europiane.

Produkte te ketij impianti do te jete betoni i markave te ndryshme sipas kekesave te tregut. Linja e prodhimit ka nje kapacitet prodhues variabel dhe punon me cikël te mbyllur. Produkti i ketij impianti do te furnizoje industrine e ndertimit ne zone ku eshte vendosur fabrika e me gjere.

Ne baze te fraksioneve inerte te perdorura, raporteve midis tyre dhe aditiveve te lidhjes se granulave (cimento) ne fabrike do te prodhohen si me poshte: Masa volumetrike relative e betonit te prodhuar do te jete 2371 Kg/m³.

<i>Rere %</i>	<i>Granil 1 -2 %</i>	<i>Cimento (kg)</i>	<i>Marka e betonit</i>
40%	60%	220	M – 100
40%	60%	270	M - 150
40%	60%	295	M – 200
40%	60%	355	M - 350

Procesi i prodhimit te betonit.

Linja e prodhimit te betonit, eshte nje teknologji e parametrave bashkohore ne te cilin cikli i prodhimit eshte i mbyllur dhe me kontakte teper minimale me

elementet e mjedisit. Impianti i prodhimit te betonit perbehet nga keto njesi teknologjike funksionale si me poshte.

Bunkeret e depozitimit te materialit inert te fraksionuar sipas granulometrise te pershkruar me siper per tre fraksionet rere dhe granil 1 dhe 2. Fraksionet qe depozitohen aty jane ne gjendje te lagur dhe vijne direkt nga sillozet e impiantit te fraksionimit te inerteve. Bunkeret jane ne forme hinke te rezistueshem nga goditjet.




Peshoret e dozimit te fraksioneve, keto njesi matese peshuese jane montuar ne fundin e cdo bunkeri dhe ne to matet dhe percaktohen ne mynyre automatike raportet e secilit fraksion sipas qellimeve te prodhimit per llojin e betonit. Ky proces eshte i drejtuar nga njesia e kontrollit kumputerike e impiantit.



Shtrati i pritjes dhe trasmetimit te mases se fraksioneve qe eshte nje rryp trasmissioni horizontal me gjeresi 80 cm. Ky rryp trasmissioni e drejton dhe shkarkon materialin ne nje trasmetues tjeter me kend 40 grade edhe ky perbehet nga nje rryp trasmissioni me gjeresi 60 cm qe e percjell materialin inert ne perzjeres.

Bunkeri i çimentos, është një hinke metalike i cili është montuar mbi perzjersin. Ketu mbahet e teresisht e izoluar sasia e çimentos që perzihet me materialin inert. Në fundin e këtij bunkeri gjendet një peshore që realizon dozimin përkatës të çimentos.



Perzjeresi i masave është agregati i fundit i impiantit që realizon perzjerjen e materialit inert dhe çimentos. Në pjesën e sipërme të tij janë montuar një sistem sitash vibruese homogjenizuese të fraksioneve që ndihmon në procesin e perzjerjes. Sasia e duhur e çimentos leshohet në perzjerës nëpërmjet një hinke të posaçme gjithashtu në perzjerës është montuar dhe një sistem tubacioni që i shton masën e ujit të nevojshëm për lidhjen e masave. Uji që përdoret për prodhimin e betonit merret nga sistemi i furnizimit me ujë me pompa dhe dozohet nga një aparat i posaçëm dhe i kontrolluar nga kompiuteri. Ketu mbyllet procesi i prodhimit të betonit dhe me pas ai ngarkohet në auto –betoniere. Procesi i prodhimit të betonit është teresisht një cikël i mbyllur dhe izoluar me ndikim fare minimale dhe të pakonsiderueshme në mjedis.

Njesia e komandimit të procesit është një kabine metalike 2x2m ku gjendet një kompiuter i cili komandon procesin teknologjik të prodhimit të betonit.

Me pas po rëndisim disa analiza përfaqësuese të betoneve të realizuara




Ne baze te elementeve te betonit qe do te prodhohen, zgjidhen format gjeometrike te tyre (kallepet) dhe me teje sipas markes se betonit behet derdhja e tije ne kallepet perkates dhe pas ketij operacioni behet mpiksja e materialit te derdhur ne kallep duke zbatuar te gjitha kushtet teknike duke perfshire dhe kohen e ngurtesimit dhe te formimit te tije.

Sipas kerkesave dhe games se prodhimit mund te rendisim nje sere elementesh prej betoni qe prodhon fabrika sikunder jane:

- Tubo betoni te dimensjoneve te ndryshme;
- Elemente betoni per ndertimin e urave dhe veprave te tjera te artit;
- Elemente te ndryshem per ndertime rrugeshe e trotuaresh;
- Panele betoni te dimensjoneve te ndryshme;
- Kembe bazamentesh te ndryshme;
- Elemente te ndryshme per godina banimi objekte sociale etj

Nyja e prodhimit te asfalto-betonit.
Impianti i prodhimit te asfalto – betonit.

Impianti i zgjedhur per prodhimin e asfalto – betonit eshte teknologji bashkekohore e standarteve europiane , ky investim ne kete impiant modern eshte nxitur nga eficenca e prodhimit dhe harmonia me mjedisin. Ne kete impiant do te prodhohet asfalt i cili eshte nje perberje e materialit inert me fraksione te caktuara dhe bitumit.



Asfalti është një komponent natyral i përbërë nga të gjithë karburatet që ndodhura në natyrë. Mbas rafinimit të naftës bruto (petrolit) veçohen disa përbërës të cilët rifuten në ciklin e prodhimit duke u përfshirë si përbërës të asfaltit. Asfalti ka cilësi fiziko-kimike me interes të veçantë inxhinjerieke. Është shumë rezistent,



shumë adeziv, shumë hidrofob dhe konsiderohet të jetë kimikisht inert duke qenë shumë rezistent ndaj veprimit të shumë acideve, bazave dhe kriprave. Asfalti

eshte nje material viskozo – elastik, asfalti qe do te prodhohet ne impiantin e shoqerise Victoria Invest quhet afalto-beton sepse eshte nje perbehet nga komponenti asfalt dhe minerar inert. Asfalto –betoni eshte nje nder produktet qe ka nxitur evolucionin e zhvillimit te shoqerise dhe sidomos infrastruktures rrugore.

Impianti dhe procesi i prodhimit te asfalto – betonit.

Procesi neper te cilin kalon prodhimi i asfalto-betonit ne impiat eshte nje nder me te perhapurit ne shkalle boterore. Produkti eshte nje perzjerje tipike e asfaltit te nxehur ne masen 5% dhe agregate inerte me granulometri te caktuar ne raportin 95%. Kjo perqindje raportesh leviz ne varesi te cilesive te kerkuara te prodhimit te kerkuar sipas qellimit te perdorimit.

Mbasi maten dhe percaktohen raportet e caktuara te dy komponenteve te mesiperme (bitumit dhe agregateve inerte) procesi neper te cilin kalon prodhimi eshte teper i thjeshte. Impianti i prodhimit te asfalto-betonit perbehet nga keto njesi funksionale:

- 1- Dozatoret e materialit inert** te cilet jane 4 bunkere me vellim prej 10m^3 secili. Ne keta bunkere depozitohet materiali inert i duhur per prodhim. Dozimi realizohet nepermjet peshoreve perkatese te matjes dhe dozimit. Sikunder kemi permendur dhe me siper materialet inerte sigurohen nga subjekti nepermjet perpunimit te lendeve inerte ne linjen e siperpermendur gje qe siguron nje kosto te ulet te prodhimi



2- Trasmntuesi i fraksioneve te dozuara eshte nje rryp trasmisioni me gjeresi prej 60 cm i cili percjell ne barabanin e tharjes materialin inert.

3- Barabani i tharjes se inerteve sherben per largimin e lageshtise nga lendet inerte dhe eshte nje kazan cilindrik metalik qe rrotullohet nga nje motor elektrik. Ne te realizohet proçesi i tharjes se materialit inert ku realizohet largimi i ujit nepermjet ndryshimit fazor te tij pra duke shtuar energji ne forme nxehtesi e cila ngre temperatures deri ne piken e shkeputjes se molekulave H_2O nga siperfaqja e grimcave inerte duke realizuar avullimin e ujit te pranishem. Nxehtja e mases realizohet nepermjet nje mini-kaldaje qe punon me naftë. Nafta depozitohet ne nje bunker te posaçem dhe nepermjet nje tubi te vendosur ne brendesi te barabanit emeton nxehtesi duke realizuar djegjen e saj ne ekstremin e tubit (– llamben e flakes) ne brendesi te barabanit. Futja e materialit inert dhe e nxehtesise realizohen perkundrejt njera-tjetres.

Sistemi i filterimit dhe kapjes se tymit dhe gazeve.

Eshte nje agragat i posacem i cili komunikon me barabanin nepermjet nje sistemit tubash me dm 20 cm te montuara ne faqet anesore te barabanit te tharjes. Keto tuba percjellin tymrat, avullin dhe gazet nga brendesia e barabanit ne nje sistem filtrash kompakt te vendosur sipas madhesisë se poreve duke realizuar nje filterim eficient te aerosoleve. Njesia e filterimit permban 400 filtra speciale te standartit RF-400 te cilet pastrohen dhe nderrohen vazhdimisht ne baze te shkalles se konsumit qe lidhet direkt me sasine e prodhimit te realizuar. Ne sistemin e pare te filtrave kapen grimcat e pluhurit te cilat neutralizohen plotesisht dhe pengohen te shkarkohen ne netyre. Ne pjesen e siperme te agragatit te filterimit ngrihet nje oxhak metalik me lartesi 30 m i cili shkarkon ne atmosfere ato sasi teper minimale gazesh te cilet nuk kapen dot nga blloqet e filtrave. Sasia e gazeve te emetuar CO_x dhe NO_x jane teper minimale sepse perveç perdorimit te naftes cilesore, realizohet nje djegie e plote e saj.

4- Elevatori i materialit inert:

Eshte i mbyllur dhe realizon transportin e materialit inert te thare ne kazanin e perzjerjes se masave. Elevatori levizet nga nje elektromotor i posaçem.

5- Agregati i depozitimit dhe nxehjes se bitumit :

Eshte nje agregat funksional i impiantit. Ky agregat perbehet nga dy njesi funksionale:

I.Bunkerit i depozitimit dhe nxehjes se bitumit:

Eshte nje kazan metalik me vellim 100 m^3 bitum. Neper mbeshjtjellen metalike te bunkerit eshte muntuar nje sistem tubash ku qarkullon vaji termik qe realizon nxehjen e mases se bitumit dhe e mbane ate ne gjendje te shkrire

Depozita e mbajtjes se vajit termik.

Eshte nje çisterne metalike rezistente ne te cilen jane montuar nje sistem tubacioni qe qarkullon vajin e nxehte ne kazanin e nxehjes se bitumit. Vaji termik nxehet me te njejtin parim si barabani nepermjet nje llampe qe nxjerr flake nga djegja e naftes. Gazet e çliruara nga procesi i djegjes se naftes mblidhen dhe kalojne neper nje sistem filtrash para se pjesa minimale e pakapur nga filtrat i drejtohet oxhakut perkates.




Kazani perzjeres i masave.

Eshte agregati i fundit qe mbyll ciklin e procesit teknologjik te prodhimit te asfalto – betonit. Ne kete njesi realizohet perzjerja sipas raporteve te paracaktuara te mases se inerteve dhe bitumit. Masa e lenget e bitumit para se te perzihet me inertet peshohet nepermjet nje peshore te montuar ne pjesen fundore te kazanit te bitumit. Perzjerja e masave realizohet nga levizjet rrotulluese te perzjersit.

Bunkeret e ruajtjes se produktit.

Jane dy silloze me vellim nga 10m^3 secili ne te cilet ruhet produkti perfundimtar. Prej ketej ai ngarkohet ne kamione te posaçem.

Bunkeret e ushqimit



Skeme e thjeshte e zhvillimit te procesit te prodhimit

Ndikimet e mundeshme ne mjedis dhe masat e propozuara per parandalimin edhe zbutjen e tyre

Procesi i prodhimit te materialeve inerte per ndertim nepermjet copetimit dhe fraksjonimit te tyre , prodhimi i betonit dhe elementeve prej betoni si dhe prodhimi i asfalto-betonit, jane procese teknologjike ne te cilete futen lende te para dhe fitohet produkt i gatshem dhe aplikimi i kesaj teknologjie domosdo shoqerohet me krijim mbetjesh, emetime ne atmosfere dhe si rezultat i tyre me efektet ndotese te mjedisit ku ushtrohet.

Ndikimet ne flore faun dhe gjeologji.

Zona sic eshte pershkruar dhe me lart, nuk eshte e mbushur me bimesi, pasi aktiviteti zhvillohet ne nje objekt egzistues i perfshire brenda territorit te ish kombinatit metalurgjik. Aktualisht flora dhe fauna ne zonen per te cilen behet fjale eshte zhdukur me kohe. Por gjithesesi, as fauna dhe as flora egzistuese e zones, nuk peson ndonje ndryshim te ndjeshem nga ky projekt.

Aktiviteti i shfrytezimit nuk sjell influenca negative ne folelizim, shumezim etj. Gjate fazes se shfrytezimit nuk ka elemente shqetesues per demtimin e faunes.

Po ashtu dhe fauna karakteristike e zones eshte e paprekeshme nga ndikimet e shfrytezimit te objektit, per arsye se aktiviteti i shfrytezimit nuk demton as ne lloje e as ne numur elementet e flores dhe faunes, si pjese perberese e ketij rajoni.

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne floren dhe faunen	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Shkaterrim i rendesishem habitateve natyrore		X
Ndertimi i rrugeve te reja qe kalojne ne zonat e virgjera		X
Rrezikimi i nderhyrjes ne bimet e ujit		X
Percarje/izolim habitanteve te egra		X
Interferenca midis rrugeve natyrale te emigrimit te sisoreve		X

Humbja dhe demtimi i tipareve gjeologjike,paleontologjike,problemi i mjedisit gjeologjik.

Ne pikepamje te struktures gjeologjike dhe pamjes se reljevit, kjo zone nuk ka vecori tipike dalluese dhe nuk ka asnje arsye te vleresohet ose te merret

parasyshe gjate ketij aktiviteti. Kjo zone perben nje peisazh te zakonshem gjeologjiko-gjeomorfollogjik, karakteristike e ketij rajoni.

Ndikimet fizike te projektit ne ndryshimet e topografise se zones, tokes etj.

Gjate ushtrimit te aktivitetit, nuk do te kete ndryshime te topografise lokale.

Gjate ushtrimit te aktivitetit duke patur parasyshe dhe disa masat e tjera suplementare qe kane te bejne me sistemimit dhe trajtimit, te parandaloje fenomenin e erozjonit :

- Ndikimet ne perdorimin e tokes dhe te burimeve
- Ne cilesine dhe sasine e tokes are.

Siperfaqja qe zhvillohet veprimtaria eshte nje siperfaqe e konsumuar me kohe pasi kemi te bejme me nje objekt egzistues. Pra nuk kemi te bejme me toka bujqesore.

Ushtrimi i aktivitetit ne kete zone nuk ndikon negativisht ne sasine dhe cilesine e tokes are.

Ne zonen e shfrytezuar, nuk jane parashikuar masa lidhur me ruajtien dhe mbrojtien e zonave arkeologjike apo historike, pasi nuk ka te tilla ne te.

Sic eshte theksuar dhe me siper, aktiviteti i ushtruar eshte kombinuar dhe me funksjonet e nderhyrjeve inxhinjere te objektit si shtrimin e shehsheve te punes me beton, kanalizime, drenazhime, puseta per grumbullimin e ujrave atmosferike, kanalizim i ujrave te bardha e te zeza etj. Per pasoje eshte e domosdoshme qe te ruhet sistemi i drenazhimit dhe kjo gje te coje ne evitimin e ndryshimeve jo shume te rendesishme te sistemit te ujrave te siperfaqesore.

Ne cilesine dhe sasine e tokes.

Siperfaqja ne te cilen ushtrohet aktiviteti, nuk eshte toke bujqesore. Funksjonimi i ketij aktiviteti nuk perben asnje problem persa i perket cilesise se saje.

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Humbje tokes per kullote		X
Ndryshime topografike te terrenit		X
Prishje punime bujqesore		X
Ndotje e tokes nga rrjedhjet		X
Ndotje e tokes nga mbetjet e ngurta		X
Ndotje e tokes nga depoz. llumrave		X

Ndikimet ne perfitimet e tokes.

Gjate ushtrimit te veprimtarise nuk do te kete asnje lloje ndryshimi qe lidhet me perfitime te tokes

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Prishje banesash		X
Ndryshime te rendesishme ne programet per te ardhmen e perdorimit te tokes		X
Ndotje nga CO,SO2,NOx		X
Rivendisje banesash		X
Shpronisime te tokave		X

Shkarkimet në ajër.

Kryesisht shkarkimet ne ajer rezultojne si efekt te punes se linjes se prodhimit te asfalto-betonit . Keto shkarkime kane ne perberje te tyre komponente te tille si CO2, Nox, SO2, etj.

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Prodhimi i pluhurit	X	
Ndotje nga djegia e hidrokarbureve	X	
Ndotje nga CO,SO2,NOx	X	

Grimcat e lengeta.

Grimcat e lengeta kryesisht dalin ne pah gjate proceseve te larjes se materialeve inerte ne linjen e copetimit dhe seleksjonimit te tyre si dhe ne sasi minimale gjate procesit te tharjes se inerteve ne prodhimine asfalto-betonit. Po keshtu dhe uji pastrimit te ambjenteve te punes eshte nje mbartes i papasteritve qe shoqerojne operacionet e punes.

Ne zbatim te V.K.M. Nr. 177, date 31.05.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjedisve ujore pritese". Subjekti detyrohet te ruaj percaktimet e poshteshenuara per ujrat e shkarkimit

Parametrat	Vlerat e lejuara
pH	6-9
Lendet ne pezulli	50 mg/l
COD	150 mg/l
BOD-5	50 mg/l

Funksjonimi i aktivitetit nuk sjell ndonje problem ne sasine e marrjes se ujit nga linjat per komunitetin. Ne cdo kohe do te plotesohen nevojat e komunitetit per uje te pishem dhe per cdo aktivitet tjeter qe kerkon perdorim te ujit. Ushtrimi i aktivitetit nuk do te ndikoje negativisht ne ujrat siperfaqesore.

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Trajtimi i ujrave te ndotur	X	
Ndotja e ujit nga pluhuri, derdhje aksidentale s subst. Te tjera		X
Impak sekondare ne ndotje e ujit per tokat bujqesore, ujra n/tokesore etj.		X
Modifikimi ne drenazhimin e ujrave natyrale		X
Ndotja e ujrave siperf. dhe nentokesore nga llumrat		X

Mbetjet e ngurta.

Karakterizohen nga materialet mbeturine qe dalin gjate proceseve te trajtimit te lendeve te para si mbetje llumrash, dherash, pjese te drunjeta, mbetje te ndryshme te amballazheve etj.

Mbetjet e lengeta te tjera.

Kryesisht mbetjet e lengeta perfaqesohen nga vajrat e ndryshme qe perdoren per djegie ne kaldajen e prodhimit te asfalto-betonit, per maqinerite, gjate furnizimit te rezervuarit apo ne raste te avarise se dergimit per djegie te tyre.

Ndotja e tokës.

Siç është përmendur më lart, me pare sheshet e realizimit te operacioneve te prodhimit te materialeve inerte nepermjet copetimit dhe fraksjonimit te tyre , prodhimit te betonit dhe artikujve te betonit si dhe te asfalto-betonit: jane te shtruara me beton. Në këto raste, nuk mund të ndodhë ndotja e tokës .Vec kesaj

nga subjekti jane marre masa per realizimin e depozitave te betonit ku jane montuar rezervuaret e vajrave djeges qe ne raste te avarise se rezervuarit e gjithë masa e lendes djegese mos te perhapet ne ambient por te jete e grumbulluar ne kete rezervuar betoni.

Zhurmat.

Zhurmat e cliruara do te jene brenda dhe normave dhe standarteve te miratuara per kete qellim . Me posht jepen ndikimet e ketyre zhurmave

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Rritja e nivelit egzistue te zhurmave	X	
Rritja e nivelit te zhurmave si rezultat i aktivitetit dhe makinerive	X	
Rritja e nivelit te zhurmave per njerezit		X
Nivel me i larte i zhurmave per kafshet		X

Persa i takon problemeve te vibrimeve ato jane teper minimale dhe nuk merren ne konsiderate.

Ndikimet gjate perdorimit te energjive.

Ne kete pike klasifikohen shfrytezimet e energjive dhe ndikimet e tyre

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Perdorimi ne sasi te medha te karburantit per energji	X	
Rritje te rendesishmete kerkesave per burime egzistuese te energjise apo kerkesave per tipe te tjera te energjise		X

Ndikimi ne shendetin e njeriut.

Gjate ushtrimit te veprimtarise nuk do te kete ndonje ndikim qe lidhet me influenca ne shendetin e njeriut

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne shendetin e njerezve	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Krijimi i cfaredo rreziku apo mundesie per demtimin e shendetit te njerezve		X
Krijimi i raportit te njerezve me rreziqet e mundeshme per demtimin e shendetit te tyre		X

Ndikimet ne qarkullim dhe transport.

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne qarkullim e transport	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Rritje te rendesishme te qarkullimit e transportit te automjeteve		X
Pakesim te veteqendrimit te automjeteve apo nevojave per vend qendrim te reja		X
Ndikime te rendesishme ne sistemin e komuikacionit		X
Ndryshime ne qarkullim apo te levizjes se njerezve e mallrave		X

Ndikimi ne klime.

Gjate ushtrimit te aktivitetit nuk ka ndikime ne klimen e kesaj zone

Aromat sulmuese.

Gjate ushtrimit te aktivitetit nuk ka emetime te aromave sulmuese te cdo lloj qofshin ato.

Ndikime te tjera indirekte dhe sekondare qe shoqerojne projektin

Projektet e tjera si p.sh. rruget e reja, kanalet e ujrave te zeza, banesat, linjat e energjise, telekomunikacionit etj, nuk do te ndikojne ne ushtrimin e ketij aktiviteti, pasi ne zonen qe prek ky aktivitet, nuk ka elemente te infrastruktures sic u permend me lart.

Ndikimet shoqeruese te aktivitetit me projekte te tjera egzistuese ose te propozuara.

Ushtrimi i ketij aktiviteti do te ndikojte pozitivisht ne zhvillimin e infrastruktures rrugore si dhe rritjen e nivelit social-ekonomik ne zonen ku ushtrohet

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne trashegimine kulturore	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Ndryshime apo demtime te zonave arkeologjike apo me vlera historike dhe kulturore		X

Lloji ndikimeve	Identifikimi ndikimeve	
Ne interesin publik (infrastruktura)	Gjate shfrytezimit	
	Po	Jo
Zhvillimi i aktivitetit do te kete nevojë ne fushe te interesit publik	X	
Energji elektrike		X
Sistemim i komunikacionit		X
Sistemim i kanaleve te ujrave te zeza e te bardha		X
Sistemim te ujësjes		X
Mbetje te ngurta e sistemim te tyre	X	

Identifikimi i ndikimeve pozitive te projektit.

Nder aspektet pozitive qe do te sjell veprimtaria e kesaj sipermarrije private permendim:

Nxitja e zhvillimit te zones dhe infrastruktures se saj;

Punesimi i disa punonjesve nga zona per rreth;

Ofrimi i sherbimeve te synuara, konkruese dhe me cilesi ;

Derdhja e detyrimeve monetare ne organet e shtetit ne llogari te rritjes se PBB dhe zhvillimit ekonomik te vendit.

Ndikimet tek njerezit, ndertesa dhe objektet e ndertuara nga njeriu . Ndryshimet ne popullsi.

Aktiviteti i Shoqerise "Victoria Invest" sh.p.k. , ne zonen e Bradashesheshit eshte shume i vogel ne krahasim me popullsi e rajonin.

Vete personeli i kufizuar qe do te punoje ne shfrytezimin e objektit deshmon se nuk ka ndikim ne popullsi. Por duke e pare ne kontekstet e shfrytezimit teresor te objektit mund te themi se shfrytezimi ne fjale do te kete ndikim pozitiv ne popullsi e zones, duke kontribuar drejtpersedrejti ne rritjen e mireqenies se tyre ne permisimin e infrastruktures se zones dhe punesimin e tyre.

Ndikimet e dukshme te projektit ne zonat rrethuese dhe pejsazhi.

Gjate shfrytezimit te objektit parashikohet regjenerimi hap pas hapi i ambjenteve te punes. Ne vendet e caktuara ne projekt parashikohet depozitimi te materialeve inerte pa perdorim dhe perpunimi i tij me toka vegjetale per te mundesuar mbjelljen bimet e pemet dhe pemeve karakteristike te gjelberuar dhe me shlodhese per syrin.

Ndikimet e projektit te zhvillimit ne rruget lokale dhe transportit.

Sot per sot objekti eshte i lidhur me rrugen e makines. Ky segment rruge mirembahet dhe do te mirembahet ne te ardhmen nga subjekti. Intensiteti i levizjes se makinave te transportit te subjektit ne kete segment nuk do ta rendoje trafikun aktual. Keto mjete do te jene te nje cilesie te larte dhe nuk do te perbejne asnje problem per komunitetin e kesaj zone perkundrazi do te jene nje ndihme per ta.

Ndikimet e projektit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike si dhe mbi vepra te tjera njerezore

Si rezultat i zbatimit te projektit ne kete zone nuk ka ndikim negativ mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike dhe mbi vepra te tjera njerezore, sepse ne kete zone dhe perreth saj nuk ka asnje objekt te nje rendesie te vecante te karaktereve te lartpermendura.

Pershkrimi i ndikimeve negative individuale dhe te grumbulluara ne biodiversitete duke perfshire ndikimet nderkombetar.

Sikunder eshte trajtuar edhe me lart, nga zbatimi ne praktike i projektit te copetimit dhe seleksjonimit te materialeve inerte etj, ne siperfaqen e ushtruar, nuk ka dhe nuk jane parashikuar ndikime individuale apo te grumbulluara ne biodiversitet.

Objekti eshte ne brendesi te territorit te vendit dhe nuk ka ndikime nderkufitare.

Konsekuenca te tjera ekologjike.

Ushtrimi i aktivitetit te ketij objekti nuk sjell pasoja te tjera ekologjike. Me hollesisht te dhenat konkrete per ndikimin e mundshem ne aspektin mjedisor jane dhene ne paragrafet e vecante, qe flasin per aspekte te vecanta te ndikimit mjedisor.

Masat zbutese te ndikimeve negative gjate procesit te shfrytezimit.

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate punimeve ne ajer, si pluhurat dhe zhurma, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore ne territor , faun dhe flore.

Identifikimi i masave per te eleminuar apo zbutur ndikimet negative ne mjedis.

Planifikimi i zones.

Ne zonen e vendosjes dhe shfrytezimit te objektit eshte parashikuar mbushja , sistemimi dhe perpunim te siperfaqes ku eshte montuar teknologjia e prodhimit. Kjo siperfaqe e perftuar nga trajtimet e mesiperme, do te jape mundesi per ushtrimin e veprimtarise pa probleme dhe per nje kohe te gjate, duke krijuar njeheresh kushte per parandalimin e eriozionit dhe permisimin e pamjes se pergjithshme te zones. Duhet theksuar se siperfaqia e caktuar per montimin dhe aplikimin e teknologjise se prodhimit per Shoqerine "Victoria Invest" sh.p.k. eshte shume e vogel dhe nuk perben ndonje ndikim ne zone.

Sistemi i filterimit dhe kapjes se tymit dhe gazeve

Per eliminimin ne maksimum te pluhurave dhe gazeve qe shoqerojne shkarkimet ne ajer ne procesin e prodhimit te sfalto-betonit, eshte montuar nje agragati i posacem i cili komunikon me barabanin nepermjet nje sistemit tubash me dm 20 cm te montuara ne faqet anesore te barabanit te tharjes. Keto tuba percjellin tymrat, avullin dhe gazet nga brendesia e barabanit ne nje sistem filtrash kompakt te vendosur sipas madhesis se poreve duke realizuar nje filterim eficient te aerosoleve. Njesia e filterimit permban 400 filtra speciale te standartit RF-400 te cilet pastrohen dhe nderrohen vazhdimisht ne baze te shkalles se konsumit qe lidhet direkt me sasine e prodhimit te realizuar. Ne sistemin e pare te filtrave kapen grimcat e pluhurit te cilat neutralizohen plotesisht dhe pengohen te shkarkohen ne netyre. Ne pjesen e siperme te agragatit te filterimit ngrihet nje oxhak metalik me lartesi 30 m i cili shkarkon ne atmosfere ato sasi teper minimale gazesh te cilet nuk kapen dot nga blloqet e filtrave. Sasia e gazeve te emetuar Cox dhe Nox jane teper minimale sepse pervec perdorimit te naftes cilesore, realizohet nje djegie e plote e saj.

Sistemi i shkarkimit të ujrave

Në procesin e prodhimit nuk ka ujra që duhet të shkarkohen në rrjetin komunal të zones. Vetëm një sasi e vogël uji, që përdoret për nevoja sanitare (jetsore) brenda linjes shkarkohet në rrjetin komunal të shkarkimeve. Edhe kjo sasi e vogël uji, përpara se të shkarkohet, shkon në një rezervuar të posaçëm për trajtim .

Në fabrike, në rastin e shirave, krijohet një sasi suplementare uji. Në rastin e stuhive të shiut, duke konsideruar se koeficienti i grumbullimit të tyre dhe shkarkimit në rrjetë është 0.4, fluksi maksimal i shiut është 50m/orë dhe sipërfaqja e fabrikes është rreth 11000m², kështu sasia e përgjithëshme e ujit që do të shkarkohet është;

$$Q=0.4 \times 0.050 \text{m} \times 11000 \text{m}^2 = 220 \text{m}^3 / \text{orë} = 61 \text{ l/sek}$$

Në fabriken e copetimit dhe fraksjonimit te materialeve inerte, linjes se prodhimit te betoneve si dhe linjes se prodhimit te asfalto-betonit, rrjeti i shkarkimit të ujrave të shiut do të jetë i ndarë nga rrjeti i shkarkimit të ujrave sanitare. Ujrat sanitare, derdhen në rrjetin komunal të shkarkimit të ujrave, ndërsa uji i shiut grumbullohet dhe futet në sistemin e qarkullimit të ujit të uzinës.

Vend dekantimi i ujrave para shkarkimit

Perfaqesohet nga nje grope dekantimi me nje volum prej rreth 20 m³ e betonuar dhe e paisur me sistem tropopiene. Ujrat e ardhur nga procesi i larjes se materialeve inerte, grumbullohen ne kete grope dekantimi e cila eshte llogaritur qe uji te derdhet mbi tropopiene vetem pasi te kete lene te gjitha mbetjet e ngurta ne gropen e dekantimit. Nga subjekti eshte planifiku qe ky vend dekantim te pastrohet minimumi nje here ne vit.

Baseni prites i vajrave qe perdoren per djegie

Eshte investim i realizuar nga subjekti per realizimin e nje vend depozitimi avarie te vajrave qe perdoren per djegie. Ky vend depozitim eshte nje vend i betonuar me volum rreth 30 m³ ne te cilin eshte vendosur rezervuari i vajrave per djegie me volum 20 m³. Per cdo avari te rezervuarit e gjithë masa e tijë grumbullohet ne kete vend depozitimi i cili prevenon perhapjen e mases pas avarise

Shkarkimet atmosferike, mbrojtja nga mbitensionet, tokëzimi dhe siguria në punë

Pajisjet mbrojtëse ndaj shkarkimeve atmosferike të rrjetit të shpërndarjes dhe të pajisjeve si dhe të pajisjeve të instaluar në mjediset e jashtme duhet të jenë në përputhje me mbrojtjen nga mbitensionet dhe me kërkesat për izolimin e aparateve të rrymës alternative.

Linjat do të jene te pajisura me shkarkues të tipit me oksid zinku. Kabina e transformatorit të tensionit do të jetë e pajisur me pajisje për shuarjen e frekuencave të larta. Linja 10 do të jetë e pajisur me një pajisje kapacitive për kufizimin e vlerave të tensionit dhe paneli i ushqimit do jetë i pajisur me një mbrojtës trefazor të kombinuar për mbitensionet dhe për ndryshimin e renditjes së fazave.

Për të prevenuar goditjen direkte dhe impulsin e shkarkimeve atmosferike janë marrë masat e nevojshme teknike në përputhje me standartin "Standarti për mbrojtjen e ndërtesave nga shkarkimet atmosferike".

Rrjeti i tokëzimit do të përdorë elektroda natyrale tokëzimi të ngulura direkt në tokë si dhe një rrjet të përforcuar me shirita çeliku në themelet e ndërtesave.

Sistemi mbrojtës ndaj shkarkimeve atmosferike ka një rrjet tokëzimi të veçantë, rezistenca e tij kundrejt tokës nuk duhet të jetë më e madhe se 10 ohm.

Masa te tjera qe kane te bejne me mbrojtje e mjedisit dhe qe jane merre nga subjekti per sigurimit teknik dhe mbrojtien ne pune .

Nga ana e subjektit jane, marre te gjitha masat tekniko organizative per respektimin dhe zbatimimi me korrektesi te masave te sigurimit teknik gjate punes, dhe zbatimit te standarteve nderkombetare te mbrojtjes dhe sigurise ne pune sipas standarteve

Masat e marra per eliminimin e zhurmave

Lidhur me zhurmat gjatë prodhimit projekti ka zgjedhur realizimin e një procesi të avancuar teknologjik si dhe përdorimin e pajisjeve dhe makinerive me nivel të ulët zhurmash. Veç kësaj, në përputhje me karakteristikat e gjenerimit të zhurmave të makinave dhe pajisjeve janë parashikuar dhe masa të tjera për të reduktuar zhurmat dhe vibrimet

Monitorimi dhe rekomandime.

Vetmonitormi i veprimtarise realizohet ne baze te programit individual te monitorimit ne perputhje me kerkesat e programit Kombetar te Monitorimit. Ky program duhet te trajtoje ceshtjet e meposhteme :

- 1.Monitorimin e ndikimeve ne mjedisin perreth dhe elementeve te tij (ne uje, ajer; zhurma sipas normave te percaktuara me siper).
- 2.Monitorimi i menyres se zbatimit te kushteve te Lejes Mjedisore.

3.Sasine dhe llojin e mbetjeve qe grumbullohen dhe prodhohet nga veprimtaria e subjektit (keto te ndahen ne nje vend te vecante duke i evaduar ne destinacionin e caktuar per riciklim ose perdorim. Keto ti jepen ose te dergohen ne subjektet e licensuara dhe te mbehet nje regjister i vecante per sasine e tyre me qellim qe te behet bilanci i materialeve).

Ekspert Mjedisi Kamber Haxhihyseni

Kimist teknollog Beqir Kila

